

Albanian Bulletin

NOVEMBER 2012

Tax & Legal update **Tax & Legal amendments January – November 2012**

Parlamenti Shqiptar ka adaptuar nje seri amendamentesh te legjislacionit fiskal ekzistues si dhe ka prezantuar ligje te reja me qellim mbeshtetjen dhe permiresimin e aktivitetit tregetar te bizneseve ne Shqiperi.

Ligjet dhe udhezimet e meposhtme jane amenduar ose prezantuar si te reja:

- Vendim nr.7 date 04 Janar 2012 “Per percaktimin e procedurave dhe dokumentacionit te nevojshem per arketimin e takses se rentes minerare”
- Urdher nr. 1 date 06 Janar 2012 “ Per kriteret dhe procedurat e kryerjes se rimbursimit te njesive te qeverisjes vendore te pageses per pajisjet fiskale dhe taksimetrat”
- Udhër I MF nr. 3 date 10 Janar 2012 “Per shpalljen e ndryshimeve te disa Standarteve Nderkombetare te Kontabilitetit (SNK) dhe Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF), te ndodhura gjate viteve 2010 – 2011.
- Vendim nr.94 date 07 Shkurt 2012 Per disa ndryshime ne vendimin nr.28 date 09.01.2008 te Keshillit te Ministrave “Per miratimin e lejes per ndertimin dhe shfrytezimin e linjes tregtare te interkonjeksionit me rryme te vazhduar, ndermjet Vlores (Shqiperi) dhe Brindizi – Jug (Itali)”, te ndryshuar
- Udhezim I MMPAU nr. 2/1 date 09 Shkurt 2012 Per disa shtesa dhe ndryshime ne udhezimin nr.2 date 29.06.2010 “Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar leje mjedisore”

- Ligj nr. 10/2012 date 09 Shkurt 2012 Per disa ndryshime e shtesa ne ligjin nr.9136 date 11.09.2003 “Per mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore ne Republiken e Shqiperise”, te ndryshuar.
- Udhezim I MF nr.3 date 21 Shkurt 2012 Per disa ndryshime ne udhezimin nr.19 date 01.09.2010 “Per modalitetet e aplikimit te pullave te akcizes dhe pullave fiskale ne produktet e duhanit, birres dhe alkoolit”
- Udhezim I MF nr.6 date 28 Shkurt 2012 Per disa shtesa ne udhezimin nr.26 date 04.09.2008 “Per taksat kombetare”, te ndryshuar
- Ligj nr.20/2012 date 01 Mars 2012 Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.8438 date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat” te ndryshuar
- Vendim I KM nr.200 date 21 Mars 2012 Per disa ndryshime ne vendimin nr.839 date 05.12.2007 te Keshillit te Ministrave “Per percaktimin e kushteve dhe te procedurave per rimbursimin e akcizes se paguar dhe krijimin e kushteve lehtesuese, per ndertimin e burimeve te prodhimit te energjise elektrike, me fuqi te instaluar jo me pak se 5 MW.
- Vendim I KM nr.201 date 21 Mars 2012 Per disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr.7 date 04.01.2012 te Keshillit te Ministrave “Per percaktimin e procedurave dhe dokumentacionit te nevojshem per arketimin e takses se rentes minerare”
- Ligj nr.31/2012 date 21 Mars 2012 Per disa ndryshime ne ligjin nr.7746, date 28.07.1993 “Per hidrokarburet (kerkimi dhe prodhimi)”, te ndryshuar
- Vendim I KM nr.219 date 28 Mars 2012 Per nje ndryshim ne vendimin nr.553, date 12.08.2004 te Keshillit te Ministrave “Per procedurat dhe kushtet per dhenien e lejeve te koncesionit per ndertimin dhe perdorimin e rafinerive , te naftesjellesve e gazsjellesve”, te ndryshuar
- Ligj nr. 42/2012 date 19 Prill 2012 Per ratifikimin e marreveshjes ndermjet Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise dhe Qeverise se Shtetit te Katarit per shmangien e tatimit te dyfishte dhe parandalimin e evazionit fiskal per tatimin mbi te ardhurat.

- Vendim I KM nr. 248 date 02 Maj 2012 Per disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr.347 date 29 Prill 2011 te Keshillit te Ministrave “Per miratimin e programit te veprimit 3-vjecar per zbatimin e strategjise minerare”.
- Vendimi I KM nr.281 date 02 Maj 2012 Per autorizimin e Ministrise se Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit per vendosjen e se drejtes se servitutit te kalimit ne favor te shoqerise “Tirana Business Park” shpk.
- Vendim I KM nr.286 date 02 Maj 2012 Per nje ndryshim ne vendimin nr.55 date 03.02.2010 te Keshillit te Ministrave “Per deklarimin e detyrueshem te deklaratave tatimore dhe te dokumenteve te tjera tatimore, vetem nepermjet formes elektronike.
- Udhezimi MF nr.11 date 14 Maj 2012 Per nje shtese ne udhezimin nr.17 date 13.05.2008 “Per tatimin mbi vleren e shtuar”, te ndryshuar.
- Vendim I KM nr.362 date 16 Maj 2012 Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.1158 date 13.08.2008 te Keshillit te Ministrave “Per percaktimin e kushteve dhe te procedurave per rimbursimin e akcizes se lendeve djegese, te konsumuara ne serrate me ngrohje, per prodhimin e produkteve industrial e agroindustriale, te cilat perdoren per nevoja teknologjike te prodhimit”
- Vendim I KM nr.342 date 23 Maj 2012 Per nje shtese ne vendimin nr.362 date 01.04.2009 te Keshillit te Ministrave “Per percaktimin e kriterëve, procedurave dhe te dokumentacionit per hyrjen, qendrimin dhe trajtimin e te huajve ne Republiken e Shqiperise”, te ndryshuar.
- Ligj nr. 62/2012 date 24 Maj 2012 Per nje shtese ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, te ndryshuar
- Ligj nr 61/2012 date 24 Maj 2012 Per akcizat ne Republiken e Shqiperise.
- Udhezim I MF nr.12 date 05 Qershor 2012 Mbi procedurat e kryerjes se veprimtarise se auditimit te brendshem ne sektorin publik.
- Vendim I KM nr.414, date 27 Qershor 2012 Per disa ndryshime ne vendimin nr.1114, date 30.07.2008 te Keshillit te Ministrave “Per disa ceshtje ne zbatim te ligjeve nr.7703, date 11.05.1993 “Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise, te ndryshuar nr.9136, date 11.09.2003 “Per mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve

shoqerore dhe shendetsore ne Republiken e Shqiperise, te ndryshuar dhe nr.7870 date 13.10.1994 "Per sigurimet shendetsore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar.

- Vendim I KM nr.419, date 27 Qershor 2012 Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.205 date 13.04.1999 te Keshillit te Ministrave "Per dispozitat zbatuese te Kodit Doganor", te ndryshuar.
- Ligj nr.71/2012 date 28 Qershor 2012 Per nje ndryshim ne ligjin nr.8438, date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat", te ndryshuar
- Vendim I KM nr.445, date 11 Korrik 2012 Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi.
- Vendim I KM nr.476 date 25 Korrik 2012 Per nje ndryshim ne vendimin nr.55 date 03.02.2010 te Keshillit te Ministrave "Per deklarimin e detyrueshem te deklarave tatimore dhe te dokumenteve te tjera tatimore, vetem nepermjet formes elektronike, te ndryshuar. Procedurat tatimore
- Vendim I KM nr.511, date 16 Gusht 2012 Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.205, date 13.04.1999 te Keshillit te Ministrave "Per dispozitat zbatuese te Kodit Doganor", te ndryshuar.
- Udhezim I MF nr.17 date 04 Shtator 2012 Per nje ndryshim ne udhezimin nr.19 date 01.09.2011 "Per modalitetet e aplikimit te pullave te akcizes dhe pullave fiskale ne produktet e duhanit, birres dhe alkoolit.
- Ligj nr.83/2012,date 13 Shtator 2012 Per disa shtesa ne ligjin ne.9975, date 28.07.2008 "Per taksat kombetare", te ndryshuar.
- Urdher Nr.54 date 17 Shtator 2012 Per shpalljen e disa standarteve nderkombetare te reja te raportimit financiar si dhe te disa ndryshimeve te ndodhura gjate vitit 2011 ne standartet nderkombetare te kontabilitetit (SNK) dhe ne standartet nderkombetare te raportimit financiar (SNRF)
- Udhezim I MF nr.21, date 01 Tetor 2012 per disa shtesa ne udhezimin nr.26, date 04.09.2008 " Per taksat kombetare" te ndryshuar.

1. PROCEDURAT TATIMORE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

2. Urdher nr. 1 date 06 Janar 2012 “ Per kriteret dhe procedurat e kryerjes se rimbursimit te njesive te qeverisjes vendore te pageses per pajisjet fiskale dhe taksimetrat” procedurat tatimore.

Njësitë e qeverisjes vendore, që sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar dhe vendimit nr.1065 datë 29.12.2010 “Për kriteret dhe procedurat e kryerjes së rimbursimit nga taksa e biznesit të vogël, të pagesës për pajisjet fiskale dhe taksimetrat” të Këshillit të Ministrave, kanë bërë rimbursimin e subjekteve të biznesit të vogël, brenda datës 30 prill 2011 dhe nuk kanë përfituar të gjithë fondin për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël nga Këshilli i Ministrave, brenda vitit 2011, paraqesin pranë Ministrisë së Financave (sipas formatit bashkëlidhur këtij urdhri), kërkesën për vlerën që kërkohet për t’u rimbursuar.

Kërkesa e njësive të qeverisjes vendore duhet të përmbajë:

- a) kërkesën me shkrim të firmosur nga nëpunësi i autorizuar, i njësisë, me vlerën e fondit që kërkohet për t’u rimbursuar deri në atë periudhë.
- b) listën e subjekteve të biznesit të vogël që kanë përfituar rimbursim për pajisjen fiskale dhe taksimetritin (vlerën e saj, përfshirë edhe TVSH-në, por jo më shumë se vlera e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1065, datë 29.12.2010) për ato subjekte që nuk janë të përfshira në skemën e TVSH-së dhe që nuk regjistrohen në këtë skemë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit nr.10 354, datë 18.11.2010, të rakorduar me degën rajonale të tatim-taksave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 1, date 19 Janar 2012

- **Vendim I KM nr.286 date 02 Maj 2012 Per nje ndryshim ne vendimin nr.55 date 03.02.2010 te Keshillit te Ministrave “Per deklarimin e detyrueshem te deklarave tatimore dhe te dokumenteve te tjera tatimore, vetem nepermjet formes elektronike.**

Dokumentet tatimore per deklarim online, ne kuptim te ketij vendimi jane librat e blerjes dhe të shitjes së tatimpaguesve të regjistruar për TVSH-në dhe tatimin mbi fitimin.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.59, date 29 Maj 2012

- **Ligj nr. 62/2012 date 24 Maj 2012 Per nje shtese ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, te ndryshuar**

Nga data 1 tetor 2012 taksa e akcizës administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.5.2012

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 97 date 09 Gusht 2012

- **Vendim I KM nr.476 date 25 Korrik 2012 Per nje ndryshim ne vendimin nr.55 date 03.02.2010 te Keshillit te Ministrave “Per deklarimin e detyrueshem te deklarave tatimore dhe te dokumenteve te tjera tatimore, vetem nepermjet formes elektronike, te ndryshuar. Procedurat tatimore**

Subjektet që janë të detyruara të deklarojnë dhe të paguajnë kontributet e sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, duhet të dorëzojnë në organet tatimore, brenda afateve ligjore edhe në formë shkresore, listëpagesat dhe të dhënat për ndryshimin e numrit të punonjësve për të gjitha periudhat tatimore të vitit 2012.

Për këto periudha tatimore, për efekt të zbatimit të afateve të deklarimit, do të vlerësohet dokumenti i dorëzuar apo i deklaruar më i pari në organin tatimor.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.112, date 30 Gusht 2012

3. SIGURIMET SHOQERORE DHE SHENDETSORE

- **Ligj nr. 10/2012 date 09 Shkurt 2012 Per disa ndryshime e shtesa ne ligjin nr.9136 date 11.09.2003 “Per mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore ne Republiken e Shqiperise”, te ndryshuar.**

Regjistrimi

Dy ditë pune pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, personi juridik dhe fizik duhet të deklarojë në organin tatimor listën e të punësuarve, me pagën përkatëse, përfshirë dhe listën e punonjësve të papaguar të familjes së personit fizik mbi 16 vjeç, me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht.

Detyrimi për të deklaruar

1. Personi i detyruar për të paguar kontribute, për çdo periudhë, duhet të deklarojë në organet tatimore të dhënat për kontributet në total dhe për çdo individ.

2. Deklarata për kontributet e subjektit duhet të përmbajë shumën e kontributeve, të sigurimeve shoqërore, të sigurimeve shëndetësore, për t'u paguar, numrin e kontribuesve.

3. Personat që janë të detyruar të paguajnë kontribute deklarojnë në organin tatimor të dhënat, sipas formatit të listëpagesës, ku, përveç të tjerave, shënohet për çdo person emri e mbiemri, numri personal, paga, shuma e kontributeve të sigurimeve shoqërore, të sigurimeve shëndetësore, si dhe e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për t'u paguar.

4. Forma, përmbajtja dhe rregullat e deklarimit, në organet tatimore, të kontributeve dhe ndryshimit të numrit të punonjësve, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Deklarimet dhe pagesa e kontributeve behen sipas afateve te meposhtme:

1)nga personat fizikë, përjashtuar personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Deklarata në këtë rast do të përfshijë personat e vetëpunësuar, punonjësit e papaguar të familjes si dhe të punësuarit.

2)Personi juridik e fizik është i detyruar të deklarojë zyrtarisht, në organin tatimor, çdo punonjës që fillon punë për herë të parë te subjekti apo të punësuar rishtazi pranë tij, të paktën një ditë kalendrike përpara fillimit të punës.

Të larguarit nga puna subjektet duhet t'i deklarojnë zyrtarisht në organin tatimor brenda 10 ditëve kalendrike nga data e largimit.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.2.2012

Botuar ne Fletoren Zyrtare nr.12 date 29 Shkurt 2012

- **Vendim I KM nr.414, date 27 Qershor 2012 Per disa ndryshime ne vendimin nr.1114, date 30.07.2008 te Keshillit te Ministrave "Per disa ceshtje ne zbatim te ligjeve nr.7703, date 11.05.1993 "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise, te ndryshuar nr.9136, date 11.09.2003 "Per mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore ne Republiken e Shqiperise, te ndryshuar dhe nr.7870 date 13.10.1994 "Per sigurimet shendetsore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar.**

Paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të jetë jo më pak se 18 295 (tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë, ndërsa paga maksimale mujore të jetë 91 475 (nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

Shuma minimale mujore e kontributeve për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të jetë 5 104 (pesë mijë e njëqind e katër) lekë.

Kontributi minimal sipas degëve të sigurimit të jetë:	në %	në lekë
Dega e sigurimit të sëmundjeve	0.3	55
Dega e sigurimit të barrëlindjeve	1.4	256
Dega e sigurimit të pensioneve	21.6	3 952
Dega e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale	0.3	55
Dega e sigurimit të papunësisë	0.9	165
Sigurimet shëndetësore	3.4	622

Shuma mininale mujore e kontributit të sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarin dhe për pjesëtarët e papaguar të familjes, që jetojnë e punojnë me të vetëpunësuarin, të jetë 7 për qind e pagës minimale mujore, e barabartë me 1 280 (një mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë.

I vetëpunësuar, i vetëpunësuar në ortakëri, i vetëpunësuar që punëson të tretë (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.7.2012 e në vazhdim, paguan për vete një kontribut të detyrueshëm për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 30 për qind (23 për qind, sigurim shoqëror dhe 7 për qind sigurim shëndetësor) të pagës mujore minimale prej 18 295 (tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh, të barabartë me 5 488 (pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) lekë në muaj.

I vetëpunësuar, për pjesëtarët e familjes së tij mbi 16 vjeç, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të ligjërisht (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.7.2012 e në vazhdim, paguan kontribut të detyrueshëm për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 30 për qind (23 për qind sigurim shoqëror dhe 7 për qind sigurim shëndetësor) të pagës mujore minimale prej 18 295 (tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh, të barabartë me 5 488 (pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) lekë në muaj.

Personat e vetëpunësuar në veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante, nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të deklarojnë dhe të paguajnë kontribut minimal mujor, në shumën 2 250 (dy mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë.

Personat mbi 16 vjeç, me të ardhura të rregullta nga pronësia e që nuk janë të punësuar diku tjetër, duke filluar nga 1.7.2012 e në vazhdim, të paguajnë kontribut vetëm për sigurimin shëndetësor, në masën 7 për qind të pagës mujore minimale, prej 18 295 (tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh.

Të vetëpunësuarit në bujqësi, nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të derdhin kontribut vjetor për sigurimet shoqërore, në masën 27 000 (njëzet e shtatë mijë) lekë, me përjashtim të të vetëpunësuarve, që banojnë në rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilët masa e kontributit vjetor është 20 400 (njëzet mijë e katërqind) lekë.

Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore për personat, që punojnë si punëtor

shtëpie, nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të jetë 2 250 (dy mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë nëmuaj.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2012

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 78 date 09 Korrik 2012

- **Vendim I KM nr.445, date 11 Korrik 2012 Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi.**

Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj të jetë 21 000 (njëzet e një mijë) lekë.

Paga bazë minimale, mujore, jepet për 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës.

Paga bazë minimale orare të jetë 121 (njëqind e njëzet e një) lekë.
Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.89 date 31 Korrik 2012.

4. KODI DOGANOR DHE AKCIZAT NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

- **Udhezim I MF nr.3 date 21 Shkurt 2012 Per disa ndryshime ne udhezimin nr.19 date 01.09.2010 "Per modalitetet e aplikimit te pullave te akcizes dhe pullave fiskale ne produktet e duhanit, birres dhe alkoolit"**

Secili prodhues dhe/ose importues, jo më vonë se në ditën e shtatë të punës të çdo muaji janar, prill, korrik dhe tetor të çdo viti, ose në atë ditë që furnitori dhe prodhuesit bien dakord, duhet t'i japë autoritetit:

- me anë të sistemit qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave; ose
- duke plotësuar formularin dhe dorëzimin e tij tek autoriteti, në mënyrë elektronike ose me shkrim, një parashikim, ku të parashtrohet numri i pullave të akcizës dhe i pullave fiskale që kërkohen të jenë të vlefshme në PCC për çdo importues/prodhues, së bashku me detaje të tjera siç kërkohet për çdo porosi. Çdo parashikim duhet të përmbajë këtë informacion për çdo muaj gjatë periudhës së tre muajve të njëpasnjëshëm, duke filluar me muajin e parë, menjëherë pas muajit në të cilin është kërkuar të dorëzohet parashikimi (p.sh. një parashikim i dhënë në janar duhet të mbulojë muajt shkurt deri në prill).

Porositja dhe faturimi I pullave te akcizes

Për çdo porosi të pullave të akcizës, një prodhues ose importues, jo më vonë se 15 ditë pune para datës në të cilën synon të tërheqë (vetë) ose të inspektojë (përpara eksportimit) një porosi në PCC, duhet të kryejë porosinë:

- i) me anë të sistemit qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave, të mundësuar nga autoriteti; ose
 - ii) duke plotësuar formularin e lëshuar nga autoriteti për këtë qëllim dhe dorëzimit të këtij formulari tek autoriteti, në mënyrë elektronike ose me shkrim. Çdo porosi duhet të specifikojë llojin e produktit që kërkon pullë akcize, vëllimin e njësisë së produktit prodhim vendi/importi dhe sasinë e pullave të akcizës të kërkuara, sikurse përshkruhet në shtojcën 2 pika 1, duke respektuar sasinë minimale të porosisë dhe shtesat mbi sasinë minimale (sipas përcaktimeve të shtojcës 2 pika 2).
- Autoriteti duhet t'i miratojë porositë brenda 1 dite punë nga marrja e secilës porosi me anë të sistemit qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave. Brenda 2 ditëve pune nga marrja e porosisë nga prodhuesi/importuesi, autoriteti duhet të njoftojë furnitorin me anë të sistemit qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave, që kjo porosi është miratuar

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.19 date 17 Mars 2012

- **Vendim I KM nr.200 date 21 Mars 2012 Per disa ndryshime ne vendimin nr.839 date 05.12.2007 te Keshillit te Ministrave "Per percaktimin e kushteve dhe te procedurave per rimbursimin e akcizes se paguar dhe krijimin e kushteve lehtesuese, per ndertimin e burimeve te prodhimit te energjise elektrike, me fuqi te instaluar jo me pak se 5 MW.**

Rimbursimi i akcizës për lëndën djegëse të konsumuar, të llogaritur sipas formulës, bëhet në mënyrë automatike, nga drejtoria rajonale e tatimeve ku është i regjistruar subjekti, nga llogaria e veçantë buxhetore e krijuar nga kjo drejtori për këtë qëllim.

Brenda datës 10 të muajit pasardhës, subjekti paraqet kërkesën për rimbursim. Me paraqitjen e kërkesës për rimbursim nga subjekti, drejtoria rajonale tatimore, ku subjekti është i regjistruar, është e detyruar të kryejë rimbursimin automatik të shumës së kërkuar, në rast se kërkesa për rimbursim plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) subjekti nuk bën kërkesë për rimbursim për herë të parë;
- b) është audituar në 3 (tri) vitet e fundit;
- c) nuk ka asnjë detyrim tatimor ose kontribute të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore apo penalitete pa u paguar;
- ç) ka deklarim të rregullt të TVSH-së dhe s'ka penalizime.

Kërkesa për plotësimin e kriterëve të mësipërme për rimbursimin automatik vlerësohet

dhe procedohet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga inspektorët e drejtorisë rajonale tatimore. Në rast se kërkesa për rimbursim paraqitet nga një person i tatueshëm për herë të parë, organi tatimor duhet të verifikojë në vend saktësinë e shumës së rimbursimit të kërkuar dhe e miraton atë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim.

Kontrolli i kërkesave për rimbursim bëhet duke respektuar radhën kohore të paraqitjes së kërkesave. Rimbursimi kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, pas miratimit të shumës për t'u rimbursuar.

Në rast se drejtoria rajonale tatimore, brenda 10 ditëve kalendarike, nuk procedon me rimbursimin automatik, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, në masën e akcizës së pretenduar për rimbursim.

Rimbursimi i kundërvleftës së taksës doganore, të llogaritur sipas formulës përkatëse në bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e llogaritur nga llogaria e veçantë buxhetore e krijuar nga kjo drejtori për këtë qëllim dhe jo më vonë se 5 ditë nga data e kryerjes së veprimeve në doganë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Botuar ne Fletoren Zyrtare nr.35 date 17 Prill 2012.

- **Vendim I KM nr.362 date 16 Maj 2012 Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.1158 date 13.08.2008 te Keshillit te Ministrave "Per percaktimin e kushteve dhe te procedurave per rimbursimin e akcizes se lendeve djegese, te konsumuara ne serrate me ngrohje, per prodhimin e produkteve industrial e agroindustriale, te cilat perdoren per nevoja teknologjike te prodhimit"**

Skema e rimbursimit është proporcionale, si më poshtë vijon:

- gjatë tri viteve të para, 2011-2014, do të kryhet rimbursim 100% i akcizës;
- në vitin e katërt, viti 2015, do të bëhet rimbursim në masën 80% të akcizës;
- në vitin e pestë, viti 2016, do të bëhet rimbursim në masën 50%.

Rimbursimi i akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuara në serrat me ngrohje, industrinë e riciklimit të plastikës, qelqit dhe të përzier, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë, në përputhje me sasinë e produktit final, të shitur me faturë TVSH-je, bëhet nga drejtoria rajonale e tatimeve, ku është i regjistruar subjekti, në mënyrë automatike, pas paraqitjes së kërkesës.

Brenda datës 10 të muajit pasardhës, subjekti paraqet kërkesën për rimbursim. Me

paraqitjen e kërkesës për rimbursim nga subjekti, drejtoria rajonale tatimore, ku subjekti është i regjistruar, është e detyruar të kryejë rimbursimin automatik të shumës së kërkuar, në rast se

kërkesa për rimbursim plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) subjekti nuk bën kërkesë për rimbursim për herë të parë;
- b) është audituar në 3 (tri) vitet e fundit;
- c) nuk ka asnjë detyrim tatimor ose kontribute a penalitete pa u paguar;
- ç) ka deklarim të rregullt të TVSH-së.

- **Ligj nr 61/2012 date 24 Maj 2012 Per akcizat ne Republiken e Shqiperise.**

Ky ligj përcakton rregullat e përgjithshme për prodhimin, mbajtjen, magazinimin, lëvizjen dhe kontrollet mbi produktet që i nënshtrohen detyrimeve të akcizës, si dhe vendos rregullat specifike mbi akcizën që zbatohet mbi konsumin e produkteve energjetike, alkoolin dhe pijet alkoolike, duhanin dhe nënproduktet e tij.

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 tetor 2012, ndërsa pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të nenit 109 të këtij ligji hyjnë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.5.2012

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.97 date 09 Gusht 2012

- **Vendim I KM nr.419, date 27 Qershor 2012 Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.205 date 13.04.1999 te Keshillit te Ministrave "Per dispozitat zbatuese te Kodit Doganor", te ndryshuar.**

Magazinat e lira të karburanteve në portet e përcaktuara për administrimin e lëndëve djegëse

do të marrin në ngarkim produktet e marra në sasi të matura në tokë nën mbikëqyrjen e doganës.

Me qëllim lehtësimin e mbikëqyrjes në magazinat e lira do të hyjnë: karburante, lëndë djegëse, lëndë të para për prodhimin e biodiezelit dhe karburante bio.

Pagesat e kryera nga operatorët ekonomikë, për efekt të zbatimit të pikës 7 të nenit 113 dhe pikave 5 dhe 10.4 të nenit 248, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi nuk rimbursohen nga autoriteti doganor.

Garancitë e depozituara, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nga magazinat e tipit C – *duty free shops*, për efekt të shkronjës “d” të pikës 1 të nenit 247, çlirohen menjëherë nga autoritetet doganore, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.84, date 24 Korrik 2012

- **Vendim I KM nr.511, date 16 Gusht 2012 Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.205, date 13.04.1999 te Keshillit te Ministrave “Per dispozitat zbatuese te Kodit Doganor”, te ndryshuar.**

Përrjashtimi i makinerive dhe pajisjeve për ndërtime e burimeve të energjisë.

Për qëllime të nenit 2 të ligjit nr. 8987, datë 24.12.2002 “Për krijimin e kushteve lehtësuese për ndërtime e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike”, përjashtohen nga taksat doganore makineritë dhe pajisjet që bëjnë pjesë në objektin e prodhimit të energjisë elektrike me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW për burim, që përdorin lëndë djegëse të lëngëta ose të ngurta dhe pa kufizim për burimet e tjera të rinovueshme të prodhimit.

Operatori ekonomik i cili ndërton burime të prodhimit të energjisë elektrike me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW për burim, pasi të ketë marrë nga organet shtetërore përkatëse lejen për ndërtime e një objekti gjenerues, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duhet të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për sektorin e energjisë, 6 muaj para fillimit të importimit, listën e plotë e të specifikuar të makinerive dhe të pajisjeve që do të importohen vetëm për këtë objekt.

Lista e makinerive duhet të përmbajë, për çdo makineri dhe pajisje që importohet, këto specifikime:

- a) emërtimin dhe shenjat e njësisë së makinerisë/pajisjes;
- b) karakteristikat kryesore teknike të makinerisë/pajisjes, sasinë dhe çmimin e blerjes;
- c) karakteristikat e lëndëve djegëse, që përdoren, duke specifikuar llojin dhe konsumin e shprehur për njësi;
- ç) specifikime të tjera sqaruese (konsumi specifik i burimit etj.).

Rimbursimi për lëndët djegëse të përdorura për prodhim energjie

Për qëllime të nenit 3 të ligjit nr. 8987, datë 24.12.2002 “Për krijimin e kushteve lehtësuese për ndërtime e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike”, operatorit ekonomik i cili ka ndërtuar burime të prodhimit të energjisë elektrike, me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW për burim, i rimburohet taksa/tarifa doganore e paguar për lëndët djegëse të lëngëta ose të ngurta të përdorura për sasinë e energjisë së shitur apo për nevojat e veta, duke marrë në konsideratë konsumin specifik të teknologjisë së zbatuar.

Kërkesa e operatorit ekonomik për rimbursimin e kundërvleftës së taksës doganore kryhet sipas nenit 585 të këtij vendimi, në zyrën doganore mbikëqyrëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të pikave 8 dhe 9 të këtij vendimi, të cilat hyjnë në fuqi më 1 tetor 2012.

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 118, date 11 Shtator 2012.

- **Udhezim I MF nr.17 date 04 Shtator 2012 Per nje ndryshim ne udhezimin nr.19 date 01.09.2011 “Per modalitetet e aplikimit te pullave te akcizes dhe pullave fiskale ne produktet e duhanit, birres dhe alkoolit.**

Gjashtembedhjetë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi (9 janar 2013), asnjë produkt pa pullën e akcizës apo pullën fiskale sipas këtij udhëzimi, nuk mund të shitet apo të shpërndahet në territorin e Shqipërisë, me përjashtim të produkteve me NK 2208 sipas shtojcës nr. 1: Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë, të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Të gjithë importuesit dhe prodhuesit e produkteve të akcizës, me përjashtim të produkteve me NK 2208 sipas shtojcës nr. 1: Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë, të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të cilët kanë paguar detyrimin e akcizës nëpërmjet pullave të akcizës së prodhuar nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë para datës 9 mars 2012 dhe i kanë gjendje stok në magazinat e tyre të tilla produkte në datën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, duhet që brenda datës 10 shtator 2012 të deklarojnë stokun në organin tatimor ku janë të regjistruar dhe lejohen ta shesin këtë produkt stok deri në datën 9 janar 2013.

Në rast se deri në datën 9 janar 2013, importuesit dhe prodhuesit e produkteve të akcizës, me përjashtim të produkteve me NK 2208, vlerësojnë se nuk mund ta shesin stokun e datës 10 shtator 2012, të deklaruar tek administrata tatimore, deri në datën 9 janar 2013, atëherë gjatë muajit dhjetor 2012 këto subjekte duhet të marrin masa që të pajisen me pullën fiskale të prodhuar nga Koncesionari për stokun e deklaruar tek administrata tatimore të datës 10 shtator 2012, sipas procedurës së porositjes së pullave fiskale të udhëzimit nr. 19, datë 1.9.2011. Autoriteti kontraktues autorizon mbivendosjen e pullave të prodhuara nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë me pullat e reja të prodhuara nga Koncesionari vetëm përkundrejt pagesës së kostos së printimit të pullës së re.

Përjashtimisht, në rastin e prodhuesve të produktit birra, të cilët kanë prodhuar birra para datës 9 mars 2012 dhe kanë deklaruar gjendje stok tek administrata tatimore në datën 10 shtator 2012, pajisjen me pullë fiskale të prodhuar nga Koncesionari, sipas procedurave të parashikuara në udhëzimin nr. 19, datë 1.9.2011, kundrejt pagesës së akcizës dhe kostove të printimit të pullave fiskale. Kërkesës për pulla fiskale të prodhuara nga Koncesionari, duhet t’i bashkëlidhet detyrimisht dokumentacioni që provon prodhimin e produktit para datës 9 mars 2012.

Në këtë udhëzim nuk përfshihen subjektet e tregtisë me shumicë ose pakicë që mbajnë e tregtojnë produktet e mësipërme të akcizës. Këto subjekte nuk duhet të pranojnë të blejnë produkte akcize me pullën e prodhuar nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë pas datës 9 janar 2013.

Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi menjëherë.
Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.121, date 18 Shtator 2012

5. TATIMI MBI VLEREN E SHTUAR (TVSH)

- **Udhezimi MF nr.11 date 14 Maj 2012 Per nje shtese ne udhezimin nr.17 date 13.05.2008 “Per tatimin mbi vleren e shtuar”, te ndryshuar.**

Operacionet hidrokarbure

Në rastin e importimit të mallrave dhe shërbimeve që lidhen me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure, të kryera nga kontraktorët ose nënkontraktorët që punojnë për këto operacione, për të përfituar përjashtimin nga TVSH-ja në import, subjektet duhet të paraqesin pranë organit doganor një vërtetim nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për kontraktorët dhe nënkontraktorët, së bashku me listën e mallrave të importuara.

Brenda datës 5 të çdo muaji, administrata doganore i përcjell administratës tatimore listën e detajuar të mallrave të importuara nga kontraktorët dhe nënkontraktorët.

Në rastin e importimit të nënprodukteve të naftës, për nevojat e veta, nga subjektet e kërkimit të naftës dhe të vënies në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse, përjashtimi nga TVSH-ja jepet për produktet dhe sasi të përcaktuara në autorizimet e përjashtimit të akcizës të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në bazë të udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, udhëzimi nr. 3, datë 4.5.2012 “Për përcaktimin dhe dokumentimin e sasive të nënprodukteve të naftës, të importuara për nevojat e veta, nga shoqëritë e kërkimit të naftës dhe të vënies në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.59, date 29 Maj 2012

6. TATIMI MBI TE ARDHURAT

- **Ligj nr.20/2012 date 01 Mars 2012 Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.8438 date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat” te ndryshuar**

Deklarata individuale vjetore e të ardhurave

Tatimpaguesit individë, rezidentë në Republikën e Shqipërisë, që realizojnë të ardhura të tatueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore. Deklarues të të ardhurave individuale vjetore janë edhe tatimpaguesit jorezidentë, të cilët krijojnë të ardhura të tatueshme me burim në Republikën e Shqipërisë.

Tatimpaguesit e përcaktuar në paragrafin e mesiperm dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi.

Çdo deklaratë individuale vjetore e të ardhurave plotësohet me numrin e identifikimit personal në letërnjoftimin e individit, i cili shërben si kodi fiskal i individit. Edhe në rastin kur individi është person jorezident në Republikën e Shqipërisë, si kod fiskal shërben numri i identifikimit personal në letërnjoftimin e individit.

Përfshihen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2 000 000 (dy milionë) lekë. Përveç tatimpaguesve të parashikuar në këtë nen, deklarata vjetore e të ardhurave mund të plotësohet edhe nga persona të tjerë, që vendosin të bëjnë deklaratën, megjithëse nuk kanë detyrimin ligjor për këtë, për arsye se duan të përfitojnë nga skema e shpenzimeve të zbritshme, e parashikuar në këtë ligj, kur këta individë plotësojnë kushtet e përfitimit të zbritjes së shpenzimeve.

Individi ka të drejtë të bëjë korigjimin e deklaratës deri në dy herë, pa u penalizuar. Nëse nga ana e tij korigjimi brenda këtij afati tremujor ndryshon për herë të tretë, ndaj tij aplikohen sanksionet, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 115 "Plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore dhe kërkesa e pasaktë për rimbursim" të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Në rast se shuma e të ardhurave të përcaktuara në pikën 1 e tejkalon masën prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh në vit, individi detyrohet të plotësojë dhe të dorëzojë deklaratën e të ardhurave individuale vjetore, vetëm nëse shuma e të ardhurave vjetore bruto, sipas pikës 1, e tejkalon shumën prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh.

Tatimpaguesit, të cilët nuk janë subjekt i deklarimit, sipas pikës 4 të nenit 13 të këtij ligji, por duan të plotësojnë deklaratën në bazë të pikës 5 të nenit 13 të këtij ligji, dhe kanë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet deri në shumën 1 050 000 (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë në vit (e indeksueshme çdo vit), por jo më të lartë se kjo shumë, mund të jenë subjekte deklaruese. Për efekt të llogaritjes së të ardhurës së tatueshme të këtyre individëve që plotësojnë deklaratën vjetore të të ardhurave, sipas pikës 5 të nenit 13 të këtij ligji, janë shpenzime të zbritshme shpenzimet e mëposhtme:

- a) kontributet vullnetare në fondin e pensionit vullnetar dhe kontributet vullnetare të individit për jetën dhe shëndetin, të derdhura nga vetë individi. Kufiri maksimal i shpenzimeve, i njohur për kontributet vjetore, është kufiri i përcaktuar në ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar";
- b) shuma e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari;
- c) shpenzimet për mjekim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari, për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, sipas përcaktimeve të rregulluara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Diferenca ndërmjet totalit të të ardhurave bruto dhe shpenzimeve të zbritshme përbën të ardhurën e tatueshme të individit, e cila tatóhet, me shkallën tatimore në fuqi, 10 për qind. Shumës së këtij tatimi i zbriten tatimet e paguara gjatë periudhës tatimore, të dokumentuara nga mbajtësi në burim I këtyre tatimeve. Për individët rezidentë fiskalë shqiptarë, që kanë realizuar të ardhura dhe janë taksuar për to jashtë Republikës së Shqipërisë, në vende me të cilat Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje për shmangien e

taksimit të dyfishtë, tatimet e paguara, të vërtetuara nga autoritetet e këtyre vendeve, janë të kreditueshme në masën e përcaktuar në marrëveshjet specifike. Në rast se të ardhurat i kanë realizuar dhe u janë taksuar jashtë Republikës së Shqipërisë, në vende me të cilat Shqipëria nuk ka nënshkruar marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë, tatimet e paguara nuk janë të kreditueshme

Afati për të kryer deklarinimin

Detyrimi i parë për deklarinimin e të ardhurave individuale vjetore, për vitin fiskal 2011, nga subjektet e parashikuara në këtë ligj, duhet të bëhet jo më vonë se data 30 shtator 2012, ndërsa pagesa e tatimit, sipas pikës 2 të nenit 13/6, të bëhet jo më vonë se data 30 shtator 2012.

Kreditimi i shumave të përfituara nga skema e shpenzimeve të zbritshme, parashikuar në nenin 13/3 të këtij ligji, kryhet brenda datës 31 dhjetor të vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën është hartuar deklarata, për vitin 2011. Për vitet e tjera vijuese fiskale, afatet e mësipërme janë jo më vonë se data 30 prill.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Miratuar në datën 1.3.2012

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.26, date 27 Mars 2012.

- **Ligj nr.71/2012 date 28 Qershor 2012 Per nje ndryshim ne ligjin nr.8438, date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat", te ndryshuar**

Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore, këstet tremujore të tatimin mbi fitimin, brenda datës 30 mars për muajt janar, shkurt dhe mars, brenda datës 30 qershor për muajt prill, maj dhe qershor, brenda datës 30 shtator për muajt korrik, gusht dhe shtator dhe brenda datës 30 dhjetor për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor. Këstet mund të paguhen edhe në baza mujore, jo më vonë se data 15 e çdo muaji

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2013.
Miratuar në datën 28.6.2012
Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.89, date 31 Korrik 2012.

7. TAKSAT KOMBETARE

- Udhezim I MF nr.6 date 28 Shkurt 2012 Per disa shtesa ne udhezimin nr.26 date 04.09.2008 “Per taksat kombetare”, te ndryshuar.

Taksa e rentes minerare

Për mineralin apo nënproduktin e eksportuar, eksportuesi paguan taksën e rentës minerare në çastin e bërjes së deklaratës doganore.

Nëse subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit eksporton mineralin e nxjerrë nga miniera apo nënproduktin e prodhuar prej tij nëpërmjet një subjekti tjetër të vetëm eksportues, pagesa e rentës bëhet si nga zotëruesi i lejes, pranë drejtorisë rajonale tatimore ku ai është regjistruar, ashtu dhe nga subjekti eksportues, pranë degëve doganore ku kryhen procedurat e eksportimit.

Kur zotëruesi i lejes së shfrytëzimit shet për konsum final brenda vendit mineralin apo nënproduktin e prodhuar prej tij, ai paguan taksën e rentës minerare në bankën e nivelit të dytë për llogari të drejtorisë rajonale ku është regjistruar për të gjithë sasinë e shitur brenda datës 15 të muajt pasardhës dhe brenda datës 20 rakordon me drejtorinë rajonale tatimore përkatëse për taksën e rentës minerare të paguar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.21, date 20 Mars 2012.

- **Ligj nr.83/2012,date 13 Shtator 2012 Per disa shtesa ne ligjin ne.9975, date 28.07.2008 “Per taksat kombetare”, te ndryshuar.**

Taksa e ambalazheve njëpërdorimshe të plastikës dhe të qelqit.

Taksa e ambalazheve njëpërdorimshe të plastikës caktohet në masën 100 lekë/kg dhe zbatohet si në import, ashtu edhe në prodhimin vendas. Vetëm për industrinë vendase të riciklimit, taksa për ambalazhet, të prodhuara nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në vend, caktohet në masën 50 lekë/kg.

Kjo taksë mblidhet nga administrata doganore në momentin e importit në rastet kur importohen:

i) artikuj plastikë njëpërdorimësh për ruajtjen, mbajtjen apo paketimin, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij ligji;

ii) mallra të ruajtura apo të paketuara në ambalazh plastik njëpërdorimësh, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij ligji;

Taksa për ambalazhet e prodhuara nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në vend caktohet në masën 50 lekë/kg, me kusht që subjekti të provojë këtë fakt me anë të kartës teknologjike të prodhimit, deklaratave të importimit të lëndëve të para, si dhe dokumentimit të

blerjeve të lëndëve të para brenda vendit.

Taksa e ambalazheve njëpërdorimshme të qelqit caktohet në masën 10 lekë/kg dhe zbatohet si në import, ashtu edhe në prodhimin vendas. Këto ambalazhe kanë

përmbajtjen prej qelqi, sipas klasifikimit të dhënë në kapitullin 70 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave dhe sipas listës së aneksit 2 bashkëlidhur këtij ligji.

Kjo taksë mbledhet nga administrata doganore në momentin e importit në rastet kur importohen:

- i) artikuj prej qelqi njëpërdorimësh për mbajtjen apo paketimin, sipas aneksit 2 bashkëlidhur këtij ligji;
- ii) mallra të paketuara apo të ruajtura në ambalazh prej qelqi njëpërdorimësh, sipas aneksit 2 bashkëlidhur këtij ligji.

Dispozite kalimtare

Të gjithë tatimpaguesit, të cilët kanë paguar, pranë administratës doganore, akcizë për ambalazhet e plastikës dhe të qelqit, sipas ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, dhe janë të pajisur me autorizim si tatimpagues akcize dhe kanë magazinë tatimore, në rast të shitjes së produktit (për të cilin është paguar akcizë në import) pas datës 1 tetor 2012 nuk janë subjekt i pagesës së taksave të përcaktuara në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji. Administrata tatimore dhe ajo doganore kryejnë verifikimet rast pas rasti.

Ky ligj hyn në fuqi më 1 tetor 2012.

Miratur në datën 13.9.2012

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 127 date 01 Tetor 2012

- **Udhëzim I MF nr.21, date 01 Tetor 2012 per disa shtesa ne udhezimin nr.26, date 04.09.2008 " Per taksat kombetare" te ndryshuar.**

Taksa e ambalazheve njëpërdorimësh të plastikës dhe të qelqit

"TAN", në kuptim të këtij udhëzimi, është shkurtimi i taksës së ambalazhit njëpërdorimësh.

Importuesi duhet të marrë masa që, vetë apo nëpërmjet kompanisë prodhuese apo eksportuese, të bëjë ndarjen e llojeve të ambalazhit të produkteve të importuara, për qëllimet e aplikimit të TAN.

Për mallrat me ambalazhe njëpërdorimëshe plastikë apo qelqi, të prodhuara në vend, TAN do të paguhet në momentin e shitjes së mallrave, me faturë tatimore. Për efekt pagese, subjekti prodhues do të ndajë në faturën tatimore çdo shitje të mallrave sipas kapacitetit mbajtës të ambalazhit.

Në rastet kur personat juridikë apo fizikë, prodhues të mallrave që kërkojnë ambalazh njëpërdorimësh plastik apo qelqi, furnizohen nga subjekte që importojnë apo prodhojnë këto ambalazhe, kërkojnë nga prodhuesi apo importuesi, krahas faturës tatimore, dhe pagesën e TAN në organet tatimore apo doganore.

Në rastet kur personat juridikë apo fizikë, prodhues të mallrave që kërkojnë ambalazh njëpërdorimësh plastik apo qelqi, e prodhojnë vetë ambalazhin dhe e shesin atë për të tretë, do të paguajnë TAN për sasinë e shitur me faturë tatimore.

Çdo person juridik apo fizik, prodhues i ambalazheve njëpërdorimëshe të plastikës dhe të qelqit, boshe për prodhimin e vet, si dhe çdo importues apo prodhues i ambalazheve

boshe, në fund të çdo muaji do të deklarojnë stokun në organin tatimor ku është i regjistruar. Në rast të kundërt organet tatimore do të llogarisin TAN-in e këtyre ambalazheve për të gjitha shitjet e kryera për çdo muaj.

Të gjitha subjektet prodhuese të ambalazheve njëpërdorimëshe të plastikës dhe të qelqit, brenda datës 30 tetor 2012 duhet të paraqesin pranë drejtorisë rajonale ku janë regjistruar, këto dokumente:

- a) Licencë/leje/miratim nga institucioni përkatës, për prodhimin e produkteve njëpërdorimëshe të plastikës dhe qelqit;
- b) Kopje të kartës teknologjike të prodhimit.

Të gjithë tatimpaguesit të cilët kanë paguar pranë administratës doganore, akcizë për ambalazhet e plastikës dhe të qelqit sipas ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar dhe kanë qenë të pajisur me autorizim si tatimpagues akcize dhe kanë pasur magazinë tatimore, në rast të shitjes së produktit (për të cilin është paguar akcizë në import) pas datës 1 tetor 2012 nuk janë subjekt i pagesës së TAN-it. Këta tatimpagues duhet që brenda datës 15 tetor 2012 të paraqesin pranë drejtorive rajonale ku janë të regjistruar, kopje të inventarit të ambalazheve për të cilat është paguar akciza. Administrata tatimore në bashkëpunim me administratën doganore kryejnë verifikimet rast pas rasti.

Ky udhëzim hyn në fuqi më 1 tetor 2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
Botuar ne Fletoren Zyrtare nr.127, date 01 Tetor 2012.

8. MINIERAT

Vendim nr.7 date 04 Janar 2012 "Per percaktimin e procedurave dhe dokumentacionit te nevojshem per arketimin e taksës se rentes minerare"

Renta minerare llogaritet si detyrim mujor I subjektit taksapagues, zoterues I lejes se shfrytezimit, ne castin kur ai shet apo esporton mineralin apo nenproduktin e prodhuar.

Kur subjekti zoterues I lejes se shfrytezimit shet per konsum final brenda vendit mineralin apo nenproduktin e prodhuar, renta minerare paguhet prane organit tatimor brenda dates 15 te muajit pasardhes. Vlera qe merret parasysht per aplikimin e rentes apo baza e taksueshme, mbi te cilen zbatohet renta, eshte vlera e deklaruar ne faturen e shitjes se mineralit. Detyrimi per renten, ne kete rast percaktohet duke shumezuar perqindjen e rentes me vleren totale te shitjeve ne baze te cmimeve me shumice brenda vendit ne rastin kur shitet nenprodukt, detyrimi per renten rentën percaktohet duke shumëzuar për qindjen e rentës me vlerën e mineralit të përdorur për prodhimin e nënproduktit, bazuar në normativat.

Kur subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit eksporton mineralin apo nënproduktin e prodhuar, renta minerare paguhet në degët doganore, në çastin e bërjes së deklaratës doganore të eksportit nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit, i cili është njëkohësisht dhe eksportues i produktit mineralar që eksportohet. Vlera që merret parasysht për aplikimin e rentës apo baza e taksueshme, mbi të cilën aplikohet renta minerare, është vlera e

faturës së shitjes së mineraleve apo nënprodukteve, në bazë të çmimeve të eksportit, të cilat kuptojnë çmimin FOB Shqipëri.

Nëse subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit eksporton mineralin e nxjerrë nga miniera apo nënproduktin e prodhuar nëpërmjet një subjekti tjetër të vetëm eksportues, renta, në këtë rast, paguhet si nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit, ashtu edhe nga eksportuesi, i cili rimbursohet për këtë pagesë.

Renta, për produktin e shitur (mineral apo nënprodukt), paguhet nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit pranë drejtorisë rajonale tatimore ku subjekti është i regjistruar, ndërsa nga eksportuesi, pranë organit doganor në çastin e eksportimit të mineralit apo nënproduktit të blerë nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit.

Dokumentacioni justifikues që subjekti duhet të depozitojë te degët e tatimeve, për të marrë rimbursimin përmban:

- një kopje të mandatarkëtimit të lëshuar nga dogana dhe një kopje të deklaratës doganore të eksportit, ku pasqyrohet vlera e rentës minerare të paguar në doganë (paraqitja vetëm e njërit prej dokumenteve është e mjaftueshme);
- një kopje të faturës tatimore të blerjes së mineralit nga subjekti shfrytëzues (shitës);
- një kopje të kontratës së shitjes, të lidhur ndërmjet subjektit blerës eksportues dhe shitësit të mineralit, koncentratit të mineralit apo prodhimeve metalurgjike.

- **Vendim I KM nr.201 date 21 Mars 2012 Per disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr.7 date 04.01.2012 te Keshillit te MInistrave "Per percaktimin e procedurave dhe dokumentacionit te nevojshem per arketimin e takses se rentes minerare"**

Kur subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit shet për konsum final, brenda vendit, mineralin apo nënproduktin e prodhuar, renta minerare paguhet pranë organit tatimor brenda dates 15 të muajit pasardhës. Vlera që merret parasysht për aplikimin e rentës apo baza e taksueshme, mbi të cilën zbatohet renta, është vlera e deklaruar në faturën e shitjes së mineralit, në rastin e shitjes së mineraleve. Për përcaktimin e detyrimit të rentës, si dokument bazë shërben fatura tatimore me TVSH. Detyrimi për rentën, në rastin kur shitet mineral, përcaktohet duke shumëzuar përqindjen e rentës, me vlerën totale të shitjeve. Në rastin e shitjes së produkteve/nënprodukteve që kanë përdorur lëndë të parë pasuri minerale vendase, në bazën e llogaritjes së rentës minerare përfshihet vetëm vlera e mineralit/mineraleve të përdorur për prodhimin e produktit/nënproduktit. Vlera deklarohet nga subjekti, ndërsa autoriteti tatimor ka të drejtë ta krahasojë këtë vlerë të deklaruar me vlerën referuese, sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin si lëndë të parë minerale.”.

Kur subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit eksporton mineral, renta minerare paguhet në degët doganore, në çastin e bërjes së deklaratës doganore të eksportit, nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit, i cili është njëkohësisht dhe eksportues i produktit mineral që eksportohet.

Vlera që merret parasysht për aplikimin e rentës apo baza e taksueshme, mbi të cilën aplikohet renta minerare, është vlera e faturës së shitjes së mineraleve, në bazë të

çmimeve të eksportit, që është çmimi FOB në Shqipëri. Në rastin e eksportit të produkteve/nënprodukteve që kanë përdorur lëndë të parë pasuri minerale vendase, në bazën e llogaritjes së rentës minerare përfshihet vetëm vlera e mineralit/mineraleve të përdorur/a për prodhimin produktit/nënproduktit. Vlera deklarohet nga subjekti eksportues, ndërsa autoriteti doganor ka të drejtë ta krahasojë këtë vlerë të deklaruar me vlerën referuese, sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin si lëndë të parë minerale.

- **Vendim I KM nr. 248 date 02 Maj 2012 Per disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr.347 date 29 Prill 2011 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e programit te veprimtari 3-vjecar per zbatimin e strategjise minerare".**

Të gjitha zonat minerare të përfshira në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi, duhet të vlerësohen gjatë hartimit të planit vjetor minerar, për vendosjen e tyre në lidhje me sipërfaqet e zonave të mbrojtura, pyjore/kullosore dhe zonat e shfrytëzimit të inerteve lumore. Në rast mbivendosjeje me këto sipërfaqe, përjashtimi ose përfshirja e këtyre zonave në planin vjetor minerar do të bëhet pas marrjes së miratimit nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për sipërfaqet e zonave të mbrojtura, pyjore/kullosore dhe nga KKU-ja për zonat e shfrytëzimit të inerteve lumore.

Për zonat minerare, në të cilat do të zhvillohet veprimtaria minerare gjatë periudhës 3-vjeçare, të përcaktuara me koordinatë qendre në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përcaktohen për tipin e zonës, konkurruese apo e hapur, koordinatat e zonës dhe të dhënat gjeologjike për të në planin vjetor minerar. Këto zona përditësohen në bazë të informacionit gjeologo-minerar, i cili grumbullohet gjatë kësaj periudhe.

Zonat minerare të papërfshira në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi për të cilat gjatë kësaj periudhe trevjeçare mund të shprehet interes për kërkim-zbulimin ose shfrytëzimin nga subjekte minerare, vendase ose të huaja, në bazë të vlerësimeve të strukturave përgjegjëse, si AKBN-ja, SHGJSH-ja dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, mund të përfshihen në planin vjetor minerar.

Zonat minerare të cilat kalojnë në procedurë konkurruese, si dhe zonat e hapura, përfshihen dhe caktohen në planin vjetor minerar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010. Përcaktimi i zonave në zona konkurruese dhe të hapura bëhet në bazë të vlerësimit

të strukturave përgjegjëse, si AKBN-ja, SHGJSH-ja dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.50, date 10 Maj 2012

9. MARREVESHJET E TAKSIMIT TE DYFISHTE

- Ligj nr. 42/2012 date 19 Prill 2012 Per ratifikimin e marreveshjes ndermjet Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise dhe Qeverise se Shtetit te Katarit per shmangien e tatimit te dyfishte dhe parandalimin e evazionit fiskal per tatimin mbi te ardhurat.

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së shtetit të Katarit për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimin mbi të ardhurat.

Dividentet

Tatimi i vendosur nuk do te tejkalojë 5 për qind të shumës bruto të dividendëve.

Interesi

Tatimi i vendosur nuk do te kalojë 5 perqind te shumes bruto te interesit.

Dispozitat e kësaj marrëveshjeje kanë fuqi:

- a) Në lidhje me tatimin e mbajtur në burim, në lidhje me shumat e paguara ose të kredituara më ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik menjëherë pas vitit në të cilin hyn në fuqi marrëveshja;
- dhe
- b) Në lidhje me tatimet e tjera, në lidhje me vitet fiskale që fillojnë më ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik menjëherë pas vitit në të cilin hyn në fuqi marrëveshja.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratur në datën 19.4.2012

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.52, date 14 Maj 2012

10. TE NDRYSHME

- **Udher I MF nr. 3 date 10 Janar 2012 “Per shpalljen e ndryshimeve te disa Standarteve Nderkombetare te Kontabilitetit (SNK) dhe Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF), te ndodhura gjate viteve 2010 – 2011.**

Sipas ketij urdhri shpallen ndryshimet e Standarteve Nderkombetare si me poshte:

- Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit nr.27 “Pasqyrat financiare individuale”.
- Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit nr.28 “Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e Përbashkëta”

- Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar nr.9 “Instrumentet financiare”.

Njësitë ekonomike, të cilat sipas parashikimeve të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe raportimin financiar” janë të detyruara të zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar, të aplikojnë ndryshimet si në pikën 1 të këtij urdhri, duke filluar nga data 1 janar 2013.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe në atë të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.9, date 23 Shkurt 2012.

- **Vendim nr.94 date 07 Shkurt 2012 Per disa ndryshime ne vendimin nr.28 date 09.01.2008 te Keshillit te Ministrave “Per miratimin e lejes per ndertimin dhe shfrytezimin e linjes tregtare te interkonjeksionit me rryme te vazhduar, ndermjet Vlores (Shqiperi) dhe Brindizi – Jug (Itali)”, te ndryshuar**

Në tekstin e lejes nr. 2, datë 10.12.2007, dhënë nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shoqërisë “Moncada Construzioni” s.r.l., “Për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit me rrymë të vazhduar, ndërmjet Vlorës (Shqipëri) dhe Brindizi – Jug (Itali)”, të miratuar dhe që i bashkëlidhet vendimit nr. 28, datë 9.1.2008 të Këshillit të Ministrave, vendoset se, afatet për ndërtimin dhe vënien në punë të linjës duhet të jenë: fillimi i punimeve tëndërtimit, jo më vonë se data 31 dhjetor 2012 dhe afati i përfundimit, jo me vonë se data 31 dhjetor 2015.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.14, date 07 Mars 2012.

- **Udhezim I MMPAU nr. 2/1 date 09 Shkurt 2012 Per disa shtesa dhe ndryshime ne udhezimin nr.2 date 29.06.2010 “Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar leje mjedisore”**

Për kategorinë e lejeve mjedisore të lëshuara në zbatim të nenit 40 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, të shfuqizuar me nenin 11 të ligjit nr. 9890, datë 20.3.2008 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, personat fizikë dhe juridikë, për t’u ripajisur me leje mjedisore për veprimtaritë që kanë ndikim në mjedis, do të aplikojnë pranë QKL-së duke paraqitur dokumentacionin sipas kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 249, datë 24.4.2003 “Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementeve të lejes mjedisore”, si më poshtë vijon:

- Kërkesa e personit fizik ose juridik për t'u pajisur me leje mjedisore e shoqëruar me kopje të noteruar të lejes mjedisore të mëparshme.
- Përshkrimi i projektit ose veprimtarisë që trajton:
- Ekstrakt i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për veprimtarinë për të cilën kërkohet leja e mjedisit.
- Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i hartuar nga persona fizikë e juridikë të certifikuar e të zgjedhur nga kërkuesi i lejes mjedisore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.21, date 20 Mars 2012.

- **Ligj nr.31/2012 date 21 Mars 2012 Per disa ndryshime ne ligjin nr.7746, date 28.07.1993 "Per hidrokarburet (kerkimi dhe prodhimi)", te ndryshuar**

Klauzola tranzitore dhe perjashtime

Marrëveshja "Albpetrol", e lidhur më 26 korrik 1993, me të gjitha ndryshimet e bëra deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, do të qëndrojë në fuqi edhe pas përfundimit të procesit të privatizimit.

Marrëveshja "Albpetrol" është një marrëveshje hidrokarbure e veçantë, ku të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë marrëveshje do të vazhdojnë të zbatohen mbi zonat e parashikuara në listat A, B dhe C dhe do të jenë si më poshtë:

a) Për zonat ku shoqëria "Albpetrol" kryen operacione e vetme, për të cilat nuk janë idhur marrëveshje hidrokarbure me shoqëri të treta, shoqëria "Albpetrol" ka të drejtën të kryejë operacione hidrokarbure kërkimi, zhvillimi, prodhimi dhe tregtimi të naftës e të gazit për një afat 25-vjeçar, i cili do të fillojë pas datës efektive të kontratës së blerjes së aksioneve të shoqërisë "Albpetrol", sh.a., nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë hidrokarbure. Termat dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje hidrokarbure përcaktohen si shtojcë në marrëveshjen "Albpetrol". Për sa i përket zonave të parashikuara në listën C, afatet e operacioneve hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin rregullohen në marrëveshjet hidrokarbure.

b) Për zonat, për të cilat shoqëria "Albpetrol" është autorizuar nëpërmjet licencë - marrëveshjeve të veçanta për të hyrë në marrëveshje hidrokarbure me shoqëri të treta, të drejtat, detyrimet dhe afatet e këtyre marrëveshjeve, të nënshkuara ndërmjet shoqërisë "Albpetrol" dhe këtyre shoqërive, do të mbeten të pandryshuara dhe shoqëria "Albpetrol" do të vazhdojë kryerjen e operacioneve hidrokarbure në këto zona, në përputhje me kushtet dhe termat e këtyre marrëveshjeve.

c) Shoqëria "Albpetrol" gëzon të drejtën e "ofertës së parë", për zonat për të cilat ka hyrë në marrëveshje hidrokarbure me shoqëri të treta. Në këtë rast, shoqëria "Albpetrol" do të vazhdojë kryerjen e operacioneve hidrokarbure në këto zona, në

përputhje me këto marrëveshje hidrokarbure, deri në përfundimin e afatit të parashikuar në këto të fundit, sipas kontratës së lidhur ndërmjet shoqërisë “Albpetrol” dhe ministrit përgjegjës për hidrokarburet.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.34, date 13 Prill 2012.

- **Vendim I KM nr.219 date 28 Mars 2012 Per nje ndryshim ne vendimin nr.553, date 12.08.2004 te Keshillit te Ministrave “Per procedurat dhe kushtet per dhenien e lejeve te koncesionit per ndertimin dhe perdorimin e rafinerive , te naftesjellesve e gazsjellesve”, te ndryshuar**

Leja e koncesionit negociohet dhe përgatitet nga një grup pune me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe me subjektin kërkues ose përfaqësuesin ligjor të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.44, date 29 Prill 2012.

- **Vendimi I KM nr.281 date 02 Maj 2012 Per autorizimin e Ministrise se Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit per vendosjen e se drejtes se servitutit te kalimit ne favor te shoqerise “Tirana Business Park” shpk.**

Autorizohet Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit per vendosjen e te drejtes se servitutit kalimit në favor të shoqërisë “Tirana Business Park”, sh.p.k., mbi pasuritë e paluajtshme, pronë shtetërore, me numër 88, 84/14, 84/16 dhe 218, të zones kadastrale 1669, Fushë-Prezë, Tiranë, si dhe nënshkrimin e marrëveshjes përkatëse për këtë qëllim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.47, date 06 Maj 2012.

- **Vendim I KM nr.342 date 23 Maj 2012 Per nje shtese ne vendimin nr.362 date 01.04.2009 te Keshillit te Ministrave “Per percaktimin e kritereve, procedurave dhe te dokumentacionit per hyrjen, qendrimin dhe trajtimin e te huajve ne Republiken e Shqiperise”, te ndryshuar.**

[Lista e vendeve, shtetasit e te cilave hyjne pa vize ne Republiken e Shqiperise](#)

Në lidhjen “Formati tip nr. 5-Lista e vendeve, shtetasit e të cilave hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë dhe çfarë dokumenti duhet të paraqesin”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 362, datë 1.4.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohen: Rusi, Kuvajti, Katar, Emiratet e Bashkuara Arabe, Arabia Saudite, me dokumentin pasaportë, për periudhën 25 maj deri në 25 shtator 2012.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.63, date 09 Qershor 2012.

- **Urdher Nr.54 date 17 Shtator 2012 Per shpalljen e disa standarteve nderkombetare te reja te raportimit financiar si dhe te disa ndryshimeve te ndodhura gjate vitit 2011 ne standartet nderkombetare te kontabilitetit (SNK) dhe ne standartet nderkombetare te raportimit financiar (SNRF)**

Shpallen për zbatim të Standardet Ndërkombëtare të reja të Raportimit Financiar, si dhe disa ndryshime të ndodhura gjatë vitit 2011 në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit gjatë vitit 2011, dhe të përkthyer në shqip nga gjuha angleze nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, si më poshtë:

- Standarde të reja të Raportimit Financiar (SNRF) nr. 10, nr. 11, nr. 12 dhe nr. 13.
- Kostot e Largimit në Fazën e Prodhimit të një Miniere Sipërfaqësore (KIRFN) nr. 20.
- Ndryshime në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) nr. 1, nr. 19 dhe nr. 32
- Ndryshime në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) nr.7 dhe nr. 9.

Njësitë ekonomike, të cilat sipas parashikimeve të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe raportimin financiar” janë të detyruara të zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar, të aplikojnë standartet e reja dhe ndryshimet si në pikën 1 të këtij urdhri, duke filluar nga data 1 janar 2013.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe në atë të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.130, date 08 Tetor 2012.

*

*

*

Per me shume informacion ju lutem kontaktoni:

Eniana Dupi – Tax & Legal Partner

AECO Consulting shpk

Rr. Perlat Rexhepi

Tirana

ALBANIA

Tel + 355 4500439/40

www.aeco-consulting.com

Email edupi@aeco-consulting.com

Olti Visha – Tax Assistant

ovisha@aeco-consulting.com